

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE  
T I R A N E  
Nr. 720 Rep  
Nr. 174 Kol



## KONTRATE DHURIMI KUOTASH DHE KAPITALESH

Sot me date 10.02.2001 (dymije e nje) , ne Zyren e Noterise, u paraqiten personalisht para meje

**Ne cilesine e dhuruesit**

**Stanimir Stefanov** , i biri i Kolevit i datelindjes 1964 , lindur dhe banues ne Sofie Bullgari Rr"Emil Markov " Nr 69, P.3 ap.6 madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar i njohur personalisht prej meje Noteres .

**Ne cilesine e pranuesit te dhurimit**

**Viktor Andoni** , i biri i Thanasit i datelindjes 1949 , lindur dhe banues ne Tirane madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar i njohur personalisht prej meje Noteres .

te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate :

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 8867 date 07.01.1994 eshte regjistruar si person juridik, Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SOFIMPEX "sh.p.k. , me ortaket **Z. Stanimir Stefanov dhe Z. Viktor Andoni .Duke u mbeshtetur veprimtarine e shoqerise ne Statutin dhe Kontraten e Themelimit ne ortaket e shoqerise zoterojme 50% secili te kapitalit fillestar dhe te kuotave .**

Ne baze te Vendimit Nr.1 te Asamblese te Ortakeve te kesaj shoqerie, date 10.02.2001, une Stanimir Stefanov ia dhuroj 50% te kuotave kapitalit qe zoteroj ne kete shoqeri , z .Viktor Andoni pa asnje kusht e shperblim dhe me vullnetin tim te lire e te plote.

Z.Viktor Andoni e pranoj me kenaqesi dhurimin si me siper per 50 % te kuotave te kapitalit te shoqerise se mesiperme.

Se bashku me pranimin e kuotave te kapitalit te shoqerise te dhuruar, ( 50 %) Z.Viktor Andoni pranon edhe te gjitha detyrimet ligjore qe ka shoqeria ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhurimi, dhuruesi Z. Stanimir Stefanov humbet çdo te drejte pronesie mbi 50% te kapitalit ne kete shoqeri, i cili i kalon teresisht z. Viktor Andoni .

Pronar i vetem i 50% te kapitalit behet pranuesi i dhurimit z .Viktor Andoni , duke u shenderuar shoqeria nga shoqeri me dy ortake ne shoqeri me ortak te vetem i cili zoteron 100 te kapitalit te shoqerise.

Kjo kontrate u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte ligjore dhe duke qene e bazuar ne ligj vertetohet prej meje noteris

DHURUESI

PRANUESI I DHURIMIT

*[Handwritten signature]*  
NOTERE

*[Handwritten signature]*

